

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACION	
Nr.faq/Dr.ste. <u>751</u>		
Datë/Datum. <u>11. 09. 2018</u>		
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Në pajtim me pikën 7.1 nënpika 3 të Strategjisë për përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare(2017-2021) prill 2017 dhe pikën 4.,1, 4.2 dhe 4.3 të Mekanizmit Koordinues për Zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare (2017-2021) shtator 2017, të Qeverisë së Republikës së Kosovës – Zyra për Qeverisje të Mirë, Kryetari I Komunës shpall:

### KONKURS

Për pranim të anëtarëve nga OJQ-të locale dhe ndërkombëtare në Komitetin Komunal Veprues

#### Numri i anëtarëve të Komitetit komunal veprues(KKV) të kërkuar:

- Nga OJQ të komunës – 2( dy) anëtarë
- Nga OJQ ndërkombëtare – 2 (dy) anëtarë

#### Detyrat dhe përgjegjësitë e KKV:

- Të koordinoj aktivitetet brenda komunës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali në shoqërinë Kosovare (2018-2021),
- Monitorimin e fondeve të ndara nga buxheti i komunës në raport me burimet e nevojshme financiare për zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në aktivitetin e planit të veprimit,
- Në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të mire, të ndërtoj instrumentete/format e mbledhjes së të dhënave dhe raportimit mbi zbatimin e strategjisë,
- Të mbledh dhe analizoj të dhënat e drejtorive komunale për masat e ndërmarra në kuadër të strategjisë,
- Të raportoj tek Zyra e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të mirë në baza 6 mujore dhe vjetore për të arriturat në zbatimin e strategjisë,
- Të dërgoj tek Zyra e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të mire procesverbalet e takimeve të KKV-së,
- Të propozoj masat shtesë para drejtorive komunale me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga strategjia,
- Të propozoj tek partnerët ndërkombëtarë aktivitete të planit të veprimit të cilat nuk mbulohen nga buxheti i komunës që mund të jenë në sferën e interes dhe që kërkojnë mbështetjen e tyre financiare,

- Të shërbej si një platformë për shkëmbim të informatave ndërmjet drejtorive komunale, zyrave, organizatave ndërkombëtare dhe organizatave tjera jo qeveritare,
- Të shfrytëzoj takimet e rregullta si një forum për shkëmbimin e rezultateve, mësimëve të nxjerra dhe praktikave të mira,
- Në vitin e fundit të zbatimit të planit komunal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom, Ashkali në shoqërinë Kosovare (2018-2021) duhet të bëj vlerësimin e përbushjes së objektivave të parapara me plan të veprimit.

### **Kushtet**

- OJQ lokale dhe ndërkombëtare, duhet të kenë të zhvilluar aktivitetin e tyre në programe që kanë për qëllim avancimin e pozitës së pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali,
- OJQ duhet të jetë aktive në komunë për të paktën tre vitete e fundit,
- Të jetë organizatë kredibile dhe profesionale
- Të ketë performancë të kënaqshme për sa i përket avancimit të rolit të komuniteteve Rom dhe Ashkali në integrimin e tyre në shoqëri.

### **Mandati**

Mandati i anëtarëve të Komitetit Komunal Veprues është i njëjtë me kohëzgjatjen e zbatimit të Planit Lokal të Veprimit 2018-2021.

Përzgjedhja e përfaqësuesve të OJQ-ve do të bëhet nga komisioni prej tre anëtarësh I themeluar nga Kryetari i Komunës.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

### **Dokumentet e kërkuara**

Dëshmia për regjistrimin e organizatës(OJQ-së) dhe akteve tjera val;ide për themelimin e OJQ-së si dhe dëshminë për autorizim nga OJQ-ja, të përfaqësuesit të tyre për të aplikuar në konkurs për përzgjedhjen në Komitetin Komunal Veprues.

Kërkesa për aplikim me dokumentet e kërkuara mund të dorëzohen çdo ditë pune prej orës 08:00 deri në orën 16:00 në Zyren e pranimit të Komunës së Fushë Kosovës.


  
**Kryetari i Komunës**  
**Burim Berisha**